



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Dt.06.01.2010, Nr 031-118

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës të dt.21.05.2008 në pajtim me procedurat ligjore, si dhe në bazë të Statutit të Komunës së Drenasit, përkatësisht të nenit 79 rreth detyrave dhe përgjegjësi të Drejtorisë Komunale për Arsim, Drejtori i DKA-së nxjerrë këtë:

RREGULLORE E PUNËS
për personelin administrativ të DKA-së

1. Respektimi i Ligjshmërisë dhe shkresave të tjera zyrtare të MASHT-it dhe DKA-së.
2. Respektimi dhe kryerja me kohë dhe saktë e detyrave dhe përgjegjësi të përkatëse.
3. Respektimi i Orarit të punës.
4. Respektimi i detyrave që i cakton Drejtori i DKA-së.
5. Konsultimi paraprak me Drejtorin e DKA-së për çdo vizitë zyrtare në teren.
6. Konsultimi paraprak me Drejtorin e DKA-së për përdorimin e veturës zyrtare.
7. Konsultimi paraprak me Drejtorin e DKA-së për çdo mungesë në orarin e punës.
8. Bashkëpunimi ndërkolegial për çështje të ndryshme në interes të DKA-së.
9. Ruajtja e çështjeve konfidenciale të DKA-së dhe institucioneve arsimore.
10. Mirësjellja ndaj kolegëve, drejtorëve, mësimdhënësve dhe palëve të tjera.
11. Përfaqësimi sa më dinjitoz i Drejtorisë Komunale të Arsimit.
12. Konstruktivitet të plotë gjatë vizitave dhe bashkëpunimit me institucionet arsimore.
13. Dorëzimi me kohë i planeve dhe raporteve të rregullta mujore dhe vjetore.
14. Përkujdesja dhe menaxhimi efikas i mjeteve të punës dhe teknologjisë informative.
15. Marrëdhënja reciproke dhe korrekte me Ministrinë të përkatëse dhe zyret të përkatëse.

Vërejtje: Rregullorja hynë në fuqi menjëherë dhe për moszbatimin e saj, do të merren masa administrative dhe financiare në pajtim me ligjet në fuqi !

Drenas,
më 06.01.2010



Drejtori i DKA-së:
Arsim Mehmeti, prof.